

STATUTI I SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“ANIMAL VETERINARY HOSPITAL ” SHPK

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Sot, më dt. 29 / 03 / 2018, në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar dhe ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë, Ortakët:

- Zj.Luiza Hykaj, lindur më dt.01/04/1697, ne Fier, Fier , dhe banues në Lagja 16 Prilli,Fier, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin me nr.031158465 dhe nr.personal G75401036R;
- Z.Andiol Myslim Haxhi, lindur më dt.02 /03/1992, në Kuçovë,Berat, dhe banues në Vlashuk, Kuçovë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin me nr.029810135 dhe nr.personal J20302005B;

si themelues te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosën të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II

EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

EMRI DHE EMËRTIMI TREGTAR

Emri i shoqërisë është “**ANIMAL VETERINARY HOSPITAL.**”shpk.

NENI 3

FORMA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.


NENI 4

SELIA

Shoqëria e ka seline e saj , kati I pare,në godinë 1 , katëshe nr 9, Lagja “Kryengritja e Fierit”,Fier , Bashkia Fier, pasuria nr 8/89, zona kadastrale 8531.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte (.....nese ka)



Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon
(.....nese ka)

Me vendim të Administratorit mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 5 AFATI

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

KREU III

OBJEKTI

NENI 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Farmaci veterinar, Shërbim veterinar .

KAPITALI

NENI 7

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000 (njëqinde mijë) Lekë. Ortakët Themelues kanë kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Z.Luiza Hykaj ka kontribuar në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë me 50000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

- Z.Andiol Myslim Haxhi ka kontribuar në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë me 50000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.


Kapitali Themeltar i "ANIMAL VETERINARY HOSPITAL" shpk përbëhet nga 2 (dy) kuota, nga një kuota për secilin ortak:

- Z.Luiza Hykaj, merrë 1 kuota me vlerë nominale 50000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 50% (pesëdhjetë përqindë) të kapitalit themeltar të shoqërisë
- Z.Andiol Myslim Haxhi, merrë 1 kuota me vlerë nominale 50000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 50% (pesëdhjetë përqindë) të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

Ne të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët ne të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit


- 2 -

nga gjykata te kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontributesipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 8 KUOTAT E KAPITALIT

Kuota mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

NENI 9 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë, me kushte të njëjta nga ato që do ju ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve, të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që e gëzojnë këtë të drejtë.


Personi që e kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga cast ii kalimit të kuotave, deri në castin e regjistrimit të kalimit në QKB.

Kuotat janë të pjesëtueshme.

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote.

KREU IV

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQËRISË



NENI 10

Organet Vendimmarrese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.
- Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modalitetve të përcaktuara në ligj .

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 11 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij

neni;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESESË

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 13 THIRJA , KUORUMI , VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht

parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Shoqëritë Tregëtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose në menyre elektronike sic përcaktohet në nenin 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

NENI 14

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesëve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera:

a-përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë

b-emerimin dhe shkarkimin e administratorëve

c-emerimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.

ç-përcaktimin e shpërblimeve.

d-mbikqyrjen e politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

e-perfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe procedurat e tjera ndaj administratorëve.

f- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 15

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1-Ortaku nuk mund të ushtroj të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme mer vendim për:

a-vlerësimin e veprimtarisë së tij

b-shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij

c-ngritjen e ndonjë Padije ndaj tij nga shoqëria

ç-dhënie ose jo të perfitimeve të reja

2-Kur ortakë perfaqësohet nga një perfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakë, të cilin perfaqëson.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 16

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit në QKR

Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Luiza Hykaj**.

NENI 17

KOMPETENCAT

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është i detyruar të therrase Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur >


- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e3 fundit financiare të çertifikuara.

Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 18 PERGJEGJESIT E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjes individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrvëshjeve të pamiratuara nga asambleja që sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrvëshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit 'Për Tregëtarët dhe Shoqërit Tregëtare', administratori detyrohet:

- 1- a-të kryej detyrat e tij të percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin me të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
b-të ushtroj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita.
c-të vlersoj me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.
ç-të parandaloj dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë.
d-të ushtroj detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2-Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregëtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3-Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar të demshperblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4-Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar të demshperblejë shoqërisë demet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit 'Për Tregëtarët dhe Shoqërit Tregëtare', kryen veprimet e mëposhteme:


- a-u kthen ortakëve kontributet
- b-u paguan ortakëve interesa apo dividende
- c-u shperndan aktivet shoqërisë
- ç-lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregëtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- d- jep kredi

KREU V

VITI FINANCIAR

NENI 19

Në përputhje me ligjin, shoqëria do të ketë një regjister në të cilën mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.



NENI 20

Viti financiar i shoqërise fillon ne 1 janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 dhjetor te po ketij viti me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqërise dhe perfundon ne 31 dhjetor.

DIVIDENTËT

NENI 21

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si dividente, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.

NENI 23

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise , ate gjithëvjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqes e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 24

Shoqëria prishet:

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund te behen ne çdo kohe:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- d) ne ese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

e- me vendim gjykate

Ne kete raste ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin percaktojne menyren e likuidimit te shoqërise , duke caktuar nje likuidator.

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likujdimit emrit te shoqërise i shtohet pjesa “Ne likujdim” qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqëria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimin e shoqerise prane QKB, pas shperndarjes se aktiveve te mbetura te shoqerise.

NENI 25

RIORGANIZIMI I SHOQERISE BASHKIMI –NDARJA

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per bTregetaret dhe Shoqerite Tregetare”

NENI 25

BAZA LIGJORE

Shoqeria do zhvilloj aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “, Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

NENI 26

MOSMARRREVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e tetij statuti , si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve , do jete kopetente Gjykata Shqiptare

PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

NENI 26


Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqeria ka vulen e saj, ne te cilen shkruhet emri i shoqerise sic e parashikon ligji.

Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti eshte hartuar ne 3 (tre) kopje origjinale me te njejten fuqi ligjore.

THEMELUES

Andriol Haxhi


Luriza Shykoj
